

PLANI STRATEGJIK 2013 – 2016

Fondacioni suedez Trashëgimia
Kulturore pa Kufij (CHwB)

NE RIJETËSOJMË DHE NDËRTOJMË MARRËDHËNIE



NE RIJETËSOJMË DHE NDËRTOJMË MARRËDHËNIE

FONDACIONI SUEDEZ TRASHËGIMIA KULTURORE PA KUFIJ (CHwB)

PLANI STRATEGJIK 2013 – 2016

PËRMBAJTJA

Vizioni dhe misioni ynë.....	4
Mjedisi ynë i punës – konteksti dhe prirjet.....	5
Qëllimet tona	7
Vlerat tona të punës.....	10
Metodat e qëndrueshme dhe rezultatet.....	12
Monitorimi dhe vlerësimi.....	13

Vizioni dhe misioni ynë

Fondacioni Trashëgimia Kulturore pa Kufij (CHwB) është një organizatë e pavarur joqeveritare suedeze e përkushtuar në shpëtimin dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore materiale dhe jomateriale të prekur nga konfliktet, pakujdesia ose fatkeqësitë e shkaktuara nga natyra dhe njeriu. Ne e konsiderojmë punën tonë si një kontribut jetik për ndërtimin e demokracisë dhe mbështetjen e të drejtave të njeriut. CHwB qëndron e paanë sa i përket palëve në konflikt, por jo kur është fjala për të drejtat e të gjithë njerëzve për trashëgiminë kulturore – si sot ashtu dhe në të ardhmen.

CHwB punon me trashëgiminë kulturore si një forcë aktive në pajtimin, ndërtimin e paqes dhe zhvillimin social dhe ekonomik përmes ngritjes së kapaciteteve, rritjes së ndërgjegjësimit dhe krijimit të mundësive për ruajtjen dhe shpëtimin e trashëgimisë kulturore në shoqëritë e prekura nga konflikti, pakujdesia ose fatkeqësitë e shkaktuara nga natyra dhe njeriu.

CHwB është e përkushtuar ndaj barazisë, mosdiskriminimit, pjesëmarrjes, llogaridhënies dhe transparencës.

VIZIONI YNË është që të gjithë kanë të drejtën të gëzojnë, të kenë qasje dhe të marrin pjesë në trashëgiminë kulturore.

MISIONI YNË është promovimi i trashëgimisë kulturore si një e drejtë në vetvete e njëkohësisht dhe si pasuri. CHwB punon me shoqërinë civile dhe institucionet, në të gjitha nivelet, për të forcuar ndërtimin e paqes, zhvillimin e qëndrueshëm socio-ekonomik dhe demokratik si dhe përmbushjen e të drejtave të njeriut.

Mjedisi ynë i punës - konteksti dhe prirjet

Fatkeqësitë natyrore dhe situatat e konfliktit në botë po shtohen në numër e po bëhen më të ndërlikuara. Bashkë me to edhe nevojat humanitare.

Një vështrim më i gjerë global na paraqet një peizazh ku vendet në konflikt dhe ato postkonfliktuale përballen me sfida të tilla si luftëra dhe konflikte e që si pasojë kanë dëmtimin e trashëgimisë kulturore. Shumë shpesh grupeve të ndryshme etnike i mohohen identitetet e tyre kulturore dhe ato të trashëgimisë. Shembuj të dukshëm të kësaj kanë qenë përdhosja dhe shkatërrimi i monumenteve kulturore 'të armikut'. Kjo është parë në shumë vende të botës dhe së fundmi në Irak, Siri dhe Mali. Nacionalizmi shpeshherë përcaktohet ngushtësisht prej përkufizimeve shoqërore të identitetit, të cilat ia mohojnë të drejtat pakicave.

Fatkeqësitë natyrore siç janë tërmetet, përmytjet dhe shpërthimet vullkanike ashtu si dhe ndryshimet klimatike dhe mjedisore të tilla si ndotja e ajrit, uji dhe tokës, shpyllëzimet dhe zhvillimi i infrastrukturës dëmtojnë vendet e trashëgimisë kulturore çdo vit. Përcaktimi i nevojave humanitare mund të plotësohet me përcaktimin e nevojave të trashëgimisë kulturore, duke identifikuar se çfarë mund të bëhet dhe çfarë mund të shpëtohet dhe duke e integruar këtë në fazën e rindërtimit të zonës së prekur.

Asistenca humanitare bazohet në Konventat e Gjenevës dhe në akte të tjera të së drejtës ndërkombëtare humanitare dhe të të drejtave të njeriut. Konventa e Hagës kërkon mbrojtjen e pasurisë kulturore në luftë. E drejta për trashëgiminë kulturore është pjesë përbërëse e të drejtave të njeriut.

Në shumicën e vendeve në zhvillim, politikave dhe strategjive kulturore u duhet ende kohë për t'u integruar në axhendat më të gjera politike, ekonomike dhe sociale. Mungesa e infrastrukturës dhe skena politike që ndryshon me shpejtësi shkaktojnë paqëndrueshmëri si dhe i pengojnë institucionet në zhvillimin e aftësive dhe kompetencave të nevojshme. Si rrjedhim ato priren të jenë të dobëta në menaxhimin, mbrojtjen dhe zhvillimin e trashëgimisë kulturore. Në këto rrethana, grabitja e artefakteve kulturore priret të jetë një problem i rëndë, duke i mohuar qytetarëve, njerëzimit dhe brezave të ardhshëm kulturën dhe historinë e tyre.

Shumë prej konflikteve kanë dimensione politike, kulturore dhe/ose etnike dhe përpjekjet për pajtim janë një nevojë urgjente, për zbutjen e armiqësive të mëtejshme dhe për krijimin e një situatë ku popujt dhe komunitetet të mund të jetojnë krahpërkrah përsëri. Ekzistojnë dëshmi të shumta që tregojnë se duke punuar në rindërtimin, konservimin dhe zhvillimin e siveve historike hidhen hapa drejt promovimit të proceseve të ndërtimit të paqes, të forcimit të vetëbesimit dhe zhvillimit socio-ekonomik.

CHwB është një organizatë që krijon lidhjen mes nevojave më akute e afatshkurtra dhe ndërhyrjeve më afatgjata, të orientuara për zhvillim. CHwB është gjithashtu një organizatë që, në situata postkonfliktuale, i sjell së bashku organizatat e shoqërisë civile dhe autoritetet. Në situatat akute është e domosdoshme të fillohet me planifikimin në mënyrë më afatgjatë.

CHwB ka një përvojë të thellë pune në situatat ku ekziston tensioni dhe ku institucionet qeverisëse janë të dobëta; veçanërisht në lidhje me menaxhimin, mbrojtjen dhe zhvillimin e trashëgimisë kulturore. Përdorimi dhe abuzimi është i parashikueshëm, por jo efektiv. Gjatë punës sonë në Ballkanin perëndimor ka pasur përfundim të konflikteve të armatosura dhe një zhvillim të pabarabartë drejt një stabiliteti më të gjërë. Vizioni i përbashkët i vendeve të rajonit është arritja e një integrimi të plotë në BE.

CHwB ka ndërmarrë punë në lidhje me trashëgiminë kulturore në Ballkanin perëndimor dhe Europën lindore prej gati njëzet vitesh. Kemi marrë pjesë në projekte të trashëgimisë kulturore në Tibet, Turqi, Indi, Afrikë të Jugut dhe Etiopi. Kjo përvojë na ka pajisur me një bagazh të njohurive dhe të ekspertizës për t'u përdorur edhe në kontekste të tjera ndërkombëtare.

CHwB do të vazhdojë të punojë në Ballkanin perëndimor dhe Evropën lindore. Tani jemi në procesin e zgjerimit të fushëveprimit tonë për të përfshirë zona të reja gjeografike. Rreziqet që i kanosen trashëgimisë kulturore i konsiderojmë si një kërcënim për jetët e përditshme, identitetet dhe realitetet e njerëzve sot dhe të brezave të ardhshëm. Në punën tonë ne i japim përparësi shoqërive të prekura nga konflikti ose ato postkonfliktuale/tranzicion, shoqërive të prekura nga fatkeqësitë natyrore apo të lëna pa përkujdesje, ose aty ku paraqiten nevojat specifike të trashëgimisë kulturore. Ne e përdorim trashëgiminë kulturore si një mjet për rindërtimin dhe zhvillimin e komuniteteve dhe të besimit mes popujve.

Qëllimet tona

QËLLIMI YNË I PËRGJITHSHËM është përmirësimi i kushteve dhe i mundësive për të gëzuar lirinë kulturore dhe diversitetin kulturor si dhe përdorimi gjithnjë e më i madh i trashëgimisë kulturore si një mjet për promovimin e të drejtave të njeriut, ndërtimit të paqes dhe zhvillimit demokratik.

QËLLIMI KRYESOR 1: Fuqizimi i aktivizimit të shoqërisë civile dhe llogaridhënies së institucioneve në sektorin e trashëgimisë kulturore.

Për të siguruar paqe, stabilitet, prosperitet dhe drejtësi për të gjithë, është e rëndësishme për të gjithë njerëzimin të ndërtojë shoqëri demokratike që respektojnë, mbrojnë dhe përmbushin të drejtat e njeriut. Për sa i përket trashëgimisë kulturore, Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore thekson që secili ka të drejtë të marrë pjesë në jetën kulturore dhe se shtetet duhet të ndërmarrin hapa për të garantuar ruajtjen e kulturës. Përmes qasjes së saj të bazuar në të drejtat e njeriut, CHwB punon për fuqizimin e institucioneve përgjegjëse në përmbushjen e obligimeve të tyre si dhe në mbështetjen e organizatave të shoqërisë civile në mbajtjen e institucioneve kombëtare përgjegjëse ndaj konventave me rëndësi për të drejtat e njeriut dhe për trashëgiminë kulturore.

- CHwB mbështet institucionet qeveritare të angazhuara në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore në adoptimin e praktikave të suksesshme dhe mënyrave demokratike dhe transparente të punës.
- CHwB nxit bashkëpunimin mes organizatave të shoqërisë civile dhe institucioneve publike.
- CHwB mbështet organizatat e shoqërisë civile dhe rrjetet e tyre në funksionimin si mbikqyrës për të paralajmëruar dhe ndikuar tek qeveritë kur trashëgimia është në rrezik.
- Mbështetet e drejta e grupeve të shoqërisë civile për të marrë pjesë dhe ndikuar në vendimmarrjen e sektorit publik lidhur me trashëgiminë lokale.
- Trashëgimia kulturore përdoret si mjet për krijimin e mirëkuptimit për të kaluarën tonë të përbashkët dhe të ndryshme, dhe si një gur themeli në përpjekjet për të promovuar zhvillimin demokratik.

- Inkurajimi dhe fuqizimi i dialogut ndërkulturor për të ndihmuar në ndërtimin e besimit dhe të paqes mes grupeve të ndryshme në shoqëritë e prekura nga konflikti.
- Promovimi i aktiviteteve të cilat përfshijnë diversitetin kulturor si një forcë krijuese dhe fuqizuese për bashkëjetesën paqësore dhe respektin. Integrimi i njerëzve me aftësi të kufizuara, grave dhe fëmijëve në aktivitetet dhe politikat e bazuara në qasjen e modelit shoqëror.

QËLLIMI KRYESOR 2: Vlerësimi dhe shfrytëzimi i pasurisë sociale, ekonomike, kulturore dhe mjedisore të trashëgimisë kulturore nga institucionet e shoqërisë civile dhe qeveritare në nivel lokal.

Trashëgimia kulturore të përdoret si mjet për zhvillimin social dhe ekonomik, në radhë të parë duke krijuar mundësi punësimi, duke përdorur burimet dhe teknikat vendase dhe duke mbështetur qëndrueshmërinë mjedisore. Parimet e qëndrueshmërisë promovohen gjithashtu edhe në planifikimin urban dhe hapësinor. Muzumet përkrahen për t'u kthyer në vendtakime demokratike.

- CHwB vazhdon të punojë me institucionet qeveritare, shoqërinë civile dhe OJQ-të në fuqizimin e kapaciteteve dhe të bashkëpunimit mes tyre në mënyrë që të kthehen në forcë shtytëse në proceset e demokratizimit.
- Turizmi i përgjegjshëm kulturor duhet zhvilluar veçanërisht në zonat ekonomikisht të varfëra, me fokus në pronësinë lokale.
- Puna me komunitetet lokale e bën trashëgiminë kulturore të prekshme për një numër më të madh njerëzish.
- Zejtarët vendorë zhvillojnë aftësi të tyre në konservim, gjë që përmirëson mundësitë e tyre në të përgjigjurit ndaj tregut dhe në krijimin e mundësive për punësim.
- Kapacitetet profesionale lokale fuqizohen përmes angazhimit në projekte të restaurimit/konservimit.
- Projektet restauruese/konservuese mbështeten në materialet vendase dhe bizneset lokale gjithashtu përfitojnë.

- Përfshirja aktive e publikut përmes praktikave të arritshme të interpretimit është zhvilluar në muze dhe në organizata të trashëgimisë kulturore me anë të zhvillimit të kapaciteteve profesionale.
- CHwB mbështet shtetet dhe autoritetet lokale në adoptimin e legjislacionit dhe të politikave standarde të BE-së apo atyre të tjera të përshtatshme që kanë të bëjnë me trashëgiminë kulturore, e në veçanti me proceset e planifikimit lokal. CHwB punon për rritjen e të kuptuarit nga ana e autoriteteve të rolit që trashëgimia kulturore mund të luajë në këto procese.

QËLLIMI KRYESOR 3: Një grup i gjerë dhe kualitativ profesionistësh është i gatshëm për t'u përballur me sfidat e mbrojtjes së trashëgimisë në mënyrë të përgjegjshme në disa shtete.

CHwB sheh nevojën për një numër më të madh të profesionistëve të trashëgimisë kulturore të arsimuar mirë dhe teknikisht kompetentë, në një sektor profesional në rritje. Në mënyrë që njerëzit të shijojnë trashëgiminë kulturore ajo duhet të mbrohet, gjë e cila mund të arrihet vetëm nëse ka profesionistë të kualifikuar për ta ruajtur dhe për të komunikuar vlerën e saj. Përpjekjet e CHwB-së për zhvillimin e kapaciteteve janë të bazuara në përkushtimin ndaj diversitetit, praktikave të pjesëmarrjes dhe barazisë.

- CHwB zhvillon qasje ndërdisiplinare, ku aktivitetet e restaurimit/konservimit dhe të trashëgimisë kulturore përdoren si mundësi për edukim dhe trajnim ndërkulturor, bazuar në respekt dhe në forcën e diversitetit.
- Grante të vogla për zhvillimin e kapaciteteve për OJQ-të, projekte të muzeve, botime, debate publike, punëtori të vizionimit dhe kampe të restaurimit janë siguruar.
- Kapaciteti është zhvilluar në menaxhimin dhe interpretimin krijues dhe efektiv të vendeve të trashëgimisë kulturore, përdorimin dhe mirëmbajtjen e tyre.
- Trajnimi edukativ dhe praktik në teknikat e konservimit, restaurimit dhe të interpretimit muzeologjik, është siguruar duke zvogëluar varësinë nga ekspertët e huaj.

- CHwB punon në mjedise ndërkufitare dhe ndërkulturore për forcimin e bashkëpunimeve profesionale dhe për të ndihmuar në ngritjen e besimit dhe të respektit të ndërsjellë.
- Muzeologjia dhe eko-muzeologjia e re janë konsoliduar për të nxitur përafrime të reja për trashëgiminë e prekshme dhe të paprekshme si dhe pikat ku ato takohen.
- Praktikrat gjithëpërfshirëse për ngritjen e kapaciteteve, të bazuara në mosdiskriminim, përdoren për fuqizimin e pozitës së grave, njerëzve me aftësi të kufizuara dhe grupeve të tjera të marginalizuara.
- Rrjetet dhe bashkëpunimet rajonale dhe ndërkombëtare fuqizohen në sferën e trashëgimisë kulturore të prekshme dhe asaj shpirtërore.

Vlerat tona të punës

NE BESOJMË NË

- universalitetin e trashëgimisë kulturore dhe fuqisë së saj ndikuese në ndryshimet pozitive shoqërore
- rëndësinë e bashkëpunimeve krijuese profesionale me organizatat vendore, rajonale, kombëtare dhe ndërkombëtare që punojnë në forcimin e të drejtave për trashëgiminë kulturore dhe qasjes ndaj saj në të gjitha shoqëritë
- fuqizimin e rolit të organizatave të shoqërisë civile në funksionet e tyre mbikëqyrëse për ngritjen e vetëdijes ndaj trashëgimisë kulturore dhe mbrojtjen e saj
- kontributin e trashëgimisë kulturore në ndërtimin e besimit dhe ndihmesën e saj në proceset e pajtimit
- vlerën e ndërkombëtarizmit përmes partnerëve dhe ekspertëve si dhe në rëndësinë e shkëmbimit të përvojave dhe angazhimit mes profesionistëve të ndryshëm
- një jetë të pasur dhe të larmishme kulturore me pjesëmarrjen e fuqishme të publikut

- marrëdhënie të bazuara në barazi, respekt, transparencë dhe dialog
- pronësi vendore dhe zgjidhje vendore
- qëndrueshmëri dhe respektim të resurseve të një bote të brishtë
- praktikat e përafrueshme dhe demokratike
- një kulturë të zgjidhjes së problemeve dhe të menaxhimit me pjesëmarrje

NE PROMOVOJMË

- pjesëmarrjen e atyre që i gëzojnë të drejtat, duke i respektuar dhe formuar njohuritë, aftësitë dhe dëshirat e partnerëve dhe të përfituesëve për të nisur dhe ndikuar në mënyrë aktive në proceset, politikat dhe rezultatet e projektit
- pronësinë, duke respektuar dhe fuqizuar angazhimin dhe përgjegjësinë e barabartë të partnerëve para, gjatë dhe pas bashkëpunimit
- mosdiskriminimin dhe barazinë gjinore, si një e drejtë themelore e njeriut që ne e përfshijmë dhe e fuqizojmë në çdo nivel të punës sonë me qëllim krijimin e një ndryshimi afatgjatë dhe efikas
- llogaridhënien, duke dorëzuar rezultate në mënyrë të përgjegjshme e me qasje transparente dhe përdorim efikas të burimeve
- dialogun ndërkulturor për të ndërtuar besimin dhe mirëkuptimin
- qëndrueshmërinë mjedisore, duke përdorur teknikat tradicionale vendore dhe burimet e ripërtëritshme

Metodat e qëndrueshme dhe rezultatet

PËRPARËSITË E CHwB-SË:

- sjellja së bashku e njerëzve që më parë ishin në konflikt, për të punuar në projekte kreative me qasje pjesëmarrëse dhe demokratike, duke kontribuar në mënyrë konkrete në proceset e pajtimit
- puna me një numër të madh mjetesh dhe metodologjishë të cilat promovojnë pjesëmarrjen, përfshirjen dhe pronësinë, duke forcuar shoqërinë civile dhe kapacitetet institucionale
- efikasiteti në punë, aplikimi i udhëheqjes demokratike të kombinuar me staf kompetent, të përkushtuar, profesional dhe dinamik
- aplikimi i një kulture të menaxhimit dhe të qasjes konsistente me parimet e të drejtave të njeriut, duke e pozicionuar në këtë mënyrë CHwB-në adoptimin e një qasjeje më sistematike të bazuar në të drejtat e njeriut, me fokus në të drejtën e pjesëmarrjes në kulturë

REZULTATET E PRITURA GJATË PERIUdhËS SË STRATEGJISË

- Qëndrueshmëri e rritur institucionale dhe financiare e rrjeteve rajonale.
- Ndërgjegjësim i rritur rreth vlerës së rrjeteve të profesionistëve të trashëgimisë kulturore, për zhvillim institucional dhe bashkëpunim.
- Adoptimi i praktikave të reja për interpretimin dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore nëpërmjet punës me komunitetet lokale dhe profesionistëve qeveritarë.
- Njohuri, aftësi dhe të kuptuarit e qëndrueshëm të vlerës së restaurimit/konservimit, zhvillimit dhe interpretimit të trashëgimisë kulturore jomateriale dhe materiale në komunitetet lokale, për qëllime sociale, ekonomike dhe kulturore.
- Njohuri dhe zotësi të qëndrueshme në fushat e konservimit të ndërtesave dhe planifikimit hapësinor, të zejtarëve vendas, studentëve universitarë dhe profesionistëve në agjencitë qeveritare.

- Njohja me ligjet dhe standardet ndërkombëtare që lehtësojnë hapjen e institucioneve dhe shtimin e adoptimit të modeleve me pjesëmarrje dhe demokratike të menaxhimit. Nivele më të larta të qasshmërisë të njerëzve në lloje të ndryshme të trashëgimisë kulturore.
- Zyrat ekzistuese vendore në Ballkanin perëndimor të shndërrohen në OJQ vendore të pavarura.
- CHwB-ja e shtrirë në shtete të reja.

Monitorimi dhe vlerësimi

Qëllimet, metodat dhe prioritetet e përcaktuara në këtë plan strategjik do të shqyrtohen nga zyrat e CHwB-së, Sekretariati dhe Bordi gjatë monitorimit dhe vlerësimit të kornizës së rezultateve dhe planeve vjetore të CHwB-së.

TRASHËGIMA KULTURORE PA KUFIJ (CHwB) e konsideron trashëgiminë kulturore si një element jetik të të drejtave të njeriut dhe të demokracisë dhe si një pasuri të përbashkët që i përket të gjithë njerëzimit, pavarësisht nga kombësia apo feja.

Misioni ynë është promovimi i trashëgimisë kulturore si një e drejtë në vetvete e, njëkohësisht, si pasuri. CHwB punon me shoqërinë civile dhe institucionet, në të gjitha nivelet, për të forcuar ndërtimin e paqes, zhvillimin e qëndrueshëm socio-ekonomik dhe demokratik, si dhe për përbushjen e të drejtave të njeriut.

CHwB qëndron e paanshme sa i përket palëve në konflikt, por jo dhe kur është fjala për të drejtat e të gjithë njerëzve për trashëgiminë kulturore. CHwB është e përkushtuar ndaj barazisë, mosdiskriminimit, pjesëmarrjes, llogaridhënies dhe transparencës.

Ne jemi organizatë e pavarur suedeze, me përfaqësim përmes zyrave lokale në vendet ku veprojmë, e mbështetur nga Sida (Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar), fonde të tjera dypalëshe, BE-ja, fondacionet private dhe grantet.



NE RIJETËSOJMË DHE NDËRTOJMË MARRËDHËNIE

Bordi i CHwB-së emërohet nga ICOMOS Suedia, ICOM Suedia, Bordi i Trashëgimisë Kombëtare Suedeze dhe Shoqata suedeze e Arkitektëve.



Sabbatsbergsvägen 6, SE-113 21 Stockholm, SWEDEN
Tel +46 8 32 20 71
info@chwb.org

chwb.org